



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR

KËSHILLI I BASHKISË

P/VENDIM

Nr. \_\_\_\_ DATË \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / 2024

MBI

**“MIRATIMIN E KËRKESAVE PËR DHËNIEN ME QIRA ME AFAT 10 VJECAR TË DISA PARCELAVE KULLOSORE, FOND PUBLIK NË PRONËSI TË BASHKISË ”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së R.SH, të Ligjit Nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor” (të ndryshuar), të Udhëzimit Nr. 2, datë 20.7.2016 të Ministrisë së Mjedisit “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënie e tyre për kullotje e kositje bari “ si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.6, 31.1.2024 ‘ Mbi miratimin e listës së parcelave kullosore verore / dimërore që do të kontraktohen për përdorimin me qira për kullotje për sezonin veror 2024 dhe sezonin dimëror 2024 – 2025 “, Këshilli i Bashkisë Gjirokastrë në mbledhjen e datës \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / 2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

**VENDOSI:**

1. Të miratojë kërkesat për dhënie me qira me afat 10 vjecar të parcelave kullosore verore sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETAR I KËSHILLIT**

Etleva Yzo

**KRYETAR I KËSHILLIT**

Merita Isaraj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Gjirokastrë më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024

P/VENDIM

Nr. \_\_\_\_ , datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024

**“PËR MIRATIMIN E VLERËS MAKSIMALE TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË DHE TË NIVELIT TË QIRASË MESATARE NË TREG TË LIRË 2025”**

Në mbështetje të nenit 8, nenit 24, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, të nenit 38, të ligjit nr.22/2018”Për Strehimin Social”, i ndryshuar, pika 4/a e VKM nr.362, datë 29.05.2019 për “Kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet Buxhetit të Shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, si dhe Urdhërit Nr. 745 datë 07.10.2024 për “Ngritjen e grupit të punës për miratimin e vlerës mesatare sipas strukturës së apartamenteve në treg të lirë” me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

VENDOSI

1. Miratimin e nivelit të qirasë mesatare mujore në treg të lirë sipas strukturave të apartamenteve në territorin e Bashkisë Gjirokastrë, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Cmimi mesatar Leke
1	Banesa me qira (Apartament tip garsonierë)	Muaj	1	10.000
2	Banesa me qira (Apartament 1+1)	Muaj	1	15.000
3	Banesa me qira (Apartament 2+1)	Muaj	1	19.000
4	Banesa me qira (Apartament 3+1)	Muaj	1	24.000

2. Vlera maksimale e subvencionit të qirasë është e barasvlefshme me qiratë mesatare në tregun e lirë sipas vlerave të paraqitura në këtë projekt-vendim.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR I KËSHILLIT**  
**Merita ISARAJ**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË GJIROKASTËR

P/VENDIM

Nr. \_\_\_\_ Datë. \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024

**“PËR MIRATIMIN E SISTEMEVE TË PIKËZIMIT PËR PROGRAMET SOCIALE TË STREHIMIT”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”i ndryshuar, ligjin nr. 48/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 22/2018 Për Strehimin Social”, konkretisht në nenin 15 bëhen ndryshime, ku pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me përmbajtje si vijon: “1/1. Sistemi i pikëzimit në total duhet të përmbajë 100 pikë, ku çdo kriter i përcaktuar në nenin 16, përmban 25 pikë dhe mënyra e shpërndarjes së pikëve brenda kriterëve bëhet vetë nga njesia e vetëqeverisjes vendore VKM nr.362 datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij” pika 2 dhe 2.1, VKM nr. 384 datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore” pika 12, VKM nr. 453 datë 03.07.2019 “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”. Me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024

**VENDOSI:**

1. Miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet sociale të strehimit si me poshtë:
  1. Sistemi i pikëzimit për trajtimin sipas programit të Subvencionimit të Qirasë sipas aneksit nr.1 bashkëngjitur.
  2. Sistemi i pikëzimit për trajtimin sipas programit të Subvencionimit të Interesave të Kredive sipas aneksit nr.2 bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimit Social dhe Shëndetësor
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit të tij.

**KRYETAR I KËSHILLIT**

**Merita ISARAJ**